



Shkrimtari Ismail Kadare dhe botuesi Bujar Hudhri

Onufrin e kam zgjedhur për botuesin tim të tanishëm dhe të ardhshëm, midis botuesve të tjerë shqiptarë. Më është dukur një botues serioz, por më kryesorja, më është dukur se në aksionin e tij të botimit nuk udhëhiqet nga etja për fitime, që për fat të keq është shumë e shpeshtë në jetën e sotme shqiptare dhe në vende të tjera të Europës Lindore, por ka edhe njëfarë idealizmi, domethënë në kuptimin shpirtëror të gjérave.

(Pjesë nga intervista e I. Kadaresë, dhënë së përditshmes “Rilindja”, 22.05.1996)

Among other Albanian publishers, Onufri is my choice as present and future publisher. I think Onufri is a serious publisher and, what is essential, it seems to me that, in its action of publishing, is not guided by the greed for profit, that unfortunately has become frequent in the present life of Albania and other European Eastern countries. Besides, Onufri has already demonstrated a kind of idealism, I mean in the spiritual sense of things.

(Extract from the interview of I. Kadare with the daily “Rilindja”, 22.05.1996)


## VEPRA E PLOTË

Vëllimi 1.....	60
Vëllimi 2.....	61
Vëllimi 3.....	62
Vëllimi 4.....	63
Vëllimi 5.....	64
Vëllimi 6.....	65
Vëllimi 7.....	66
Vëllimi 8.....	67
Vëllimi 9.....	68
Vëllimi 10.....	69
Vëllimi 11.....	70
Vëllimi 12.....	71
Vëllimi 13.....	72
Vëllimi 14.....	73
Vëllimi 15.....	74
Vëllimi 16.....	75
Vëllimi 17.....	76
Vëllimi 18.....	77
Vëllimi 19.....	78
Vëllimi 20.....	79

**Shenim:**

Vepra e plotë e Ismail Kadarese mund te porositet direkt nga ShtepiaeLibrit.com

Ne fund te ketij dokumenti do te gjeni udhezimet e plota.




Ky korpus i veprës së plotë të Ismail Kadaresë është i katërti që sheh dritën e botimit. Përbledhja e parë prej dhjetë vëllimesh u botua më 1980 në Prishtinë. E dyta, në Tiranë, më 1981, në dyndhjetë vëllime. Botimi francez në vitet 1994-2004, gjithashtu në dyndhjetë vëllime, ka qenë në dy gjuhë, frëngjisht dhe shqip.

Opusi i tanishëm, që i paraqitet publikut shqiptar në njëzet vëllime, është, pa dyshim, më i ploti. Duke lënë jashtë vetëm një pjesë të papërfillshme të krijimtarisë, kryesisht shkrime të rinisë së hershme dhe disa herë krijime që, sipas gjykimit të autorit, nuk plotësojnë kriteret e duhura artistike, ky botim e jep veprën e Kadaresë në përmasën integrale të saj.

Si botim testamentor, nën kujdesin e vetë autorit, ky korpus do të jetë referencial për të gjitha ribotimet e mëvonshme në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera të botës.

Si letërsi e krijuar, në pjesën më të madhe të saj, në një hapësirë dhe kohë problematike, ajo mban gjurmët dhe shenjat e tyre, të cilat nuk prekin as thelbin e as artin e saj.

Të gjitha veprat e kësaj përbledhjeje janë pajisur me një aparat shoqëruesh dhe përcillen nga parathënie autorësh nga Shqipëria, Kosova dhe gjithë bota shqiptare, si edhe nga kritikë e analistë të huaj.




Vëllimi i parë, 2007

**- QYTETI PA REKLAMA  
- DITË KAFENESH  
- PËRBINDËSHI**

Në këtë vëllim të parë, me të cilin hapet korpusi i veprës së Kadaresë, përfshihen kri-jime në prozë të periudhës së hershme të kri-jimtarisë së tij. Ndërsa romani i parë i tij, “Qyteti pa reklama”, i shkruar në Moskë në vjeshtën e vitit 1959, kur autori ishte 23 vjeç, ka mbetur në sirtar, për të parë dritën e botimit pas rënies së komunizmit, novela “Ditë kafenesh”, një fragment i romanit të sipërpermendur, i përpunuar në trajtë novele më 1962, u botua një vit më pas në dy numra të gazetës “Zëri i rinisë”. Vepra e tretë, “Përbindëshi”, shkruar më 1964 dhe botuar në revistën “Nëntori” më 1965, pas një ndalimi çerek-shekullor, qarkulloi si libër një vit përpara rënies së komunizmit.

**Vëllimi 1** 398 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-42-6  
Çmimi 1250 lekë




Vëllimi i dytë, 2007

## - GJENERALI I USHTRISË SË VDEKUR - NJËMBËDHJETË TREGIME

“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, me të cilin hapet vëllimi i dytë i veprës së Kadaresë, është kujtuar për një kohë të gjatë si romani i parë i tij. Ky roman, falë të cilit autor i ri fitoi njohje ndërkombëtare, u botua më 1963, duke njojur më pas ribotime të shumta. Pjesën e dytë të këtij vëllimi e përbëjnë njëmbëdhjetë tregime, të shkruara e të botuara gjatë dhjetëvjeçarit 1960-1970.

**Vëllimi 2** 440 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-43-3  
Çmimi 1250 lekë

---




Vëllimi i tretë, 2008

## - RRETHIMI

Vëllimi i tretë i opusit letrar të Kadaresë përmban romanin e tij “Rrethimi”. I shkruar më 1969 dhe i botuar një vit më pas, me titullin e ndryshuar “Kështjella”, romani u përkthye në shumicën e gjuhëve të huaja, me titullin e tij origjinal “Daullet e shiu”. Në këtë botim të plotë, autor i paraqet romanin me titullin “Rrethimi”, të përcaktuar si përfundimtar.

**Vëllimi 3** 382 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-44-0  
Çmimi 1250 lekë

---




Vëllimi i katërt, 2008

## - KRONIKË NË GUR - LËKURA E DAULLES

Ky vëllim përbëhet nga dy romane: “Lëkura e daulles” dhe “Kronikë në gur”. “Lëkura e daulles” u shkrua dhe u botua në vitin 1967, në revistën “Nëntori”, për të dalë një vit më pas, si libër më vete, me titullin “Dasma”. Bërrthama e romanit “Kronikë në gur” ka qenë novela “Qyteti i jugut”, shkruar dhe botuar në vitin 1964. Romani u shkrua disa vite më pas, për t'u botuar më 1971, me titullin e sotëm.

**Vëllimi 4** 382 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-45-7  
Çmimi 1250 lekë

---



Vëllimi i pestë, 2008


## - DIMRI I VETMISË SË MADHE

Romani “Dimri i vëtmisë së madhe” u shkrua më 1971, për t'u botuar një vit më pas. Ai duhej të ishte libri i dytë i triptikut “Koha e grindjes”, një sagë bashkëkohore mbi tre acarimet e Shqipërisë komuniste me ish-aleatët e saj, komunistët jugosllavë, më pas me ata sovjetikë e së fundi me maoistët kinezë. Libri i parë, grindja me jugosllavët, nuk u shkrua asnjëherë, kurse i treti, “Koncert në fund të stinës”, i ndaluar për një kohë të gjatë, u botua pak kohë para rënies së komunizmit.

I pritur keq prej kritikës zyrtare, “Dimri i vëtmisë së madhe” nuk u lejua të ribotohet, veç pas një rishikimi të autorit, në vitin 1978, nën titullin e ndryshuar “Dimri i madh”.

Versioni i tanishëm është kryesisht kthim te botimi i parë. Disa retushe artistike, që autorit i janë dukur të vlefshme, janë ruajtur nga botimi i dytë. Ndryshime të natyrës politike nuk ka.

**Vëllimi 5** 584 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-52-5  
Çmimi 1250 lekë



Vëllimi i gjashtë, 2008


## - KONCERT NË FUND TË STINËS

Pjesa përbëyllëse e diptikut “Koha e grindjes”, romani “Koncert në fund të stinës”, i shkruar në vitet 1980-1981, nuk e pa dritën e botimit, veç pas shumë vitesh. Një raport sekret i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, i viti 1983, duke e cilësuar romanin si vepër antisocialiste, që satirizonte komunizmin shqiptar dhe atë botëror, ka qenë fatal për fatin e tij. Romani u botua më 1988, në prag të rënies së komunizmit.

Teksti i versionit të botuar në këtë seri nuk ka asnjë ndryshim nga botimi fillestari.

**Vëllimi 6** 592 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-53-2  
Çmimi 1250 lekë

---




Vëllimi i shtatë, 2008

## - POEZI DHE POEMA

Në këtë vëllim përmblidhet vepra poetike e Kadaresë, krijuar midis viteve 1957 dhe 2005. Vjershat dhe poemat janë nxjerrë nga librat “Ëndërrimet”, “Shekulli im”, “Përse mendo- hen këto male”, “Motive me diell”, “Koha” dhe “Ftesë në studio”. Një pjesë, që s’kanë qenë përfshirë në këta libra, janë nxjerrë nga shtypi periodik, ku janë botuar fillimisht. Gjashtë vjersha, që botohen për herë të parë në këtë vëllim, janë nxjerrë nga arkivi personal i shkrimtarit.

**Vëllimi 7** 384 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-58-7  
Çmimi 1250 lekë

---




Vëllimi i tetë, 2008

- MUZGU I PERËNDIVE TË STEPËS
- KAMARJA E TURPIT
- KOMISIONI I FESTËS

Në këtë vëllim të tetë përmblidhen tri vepra, romanet “Muzgu i perëndive të stepës” dhe “Kamarja e turpit”, si dhe novela “Komisioni i festës”, të shkruara midis viteve 1972-1976.

Ndërsa “Kamarja e turpit” dhe “Komisioni i festës” kanë si fill bashkues marrëdhëniet e Shqipërisë me Perandorinë Otomane, rebelimin e Ali Tepelenës dhe terrorin shtetëror osman, “Muzgu i perëndive të stepës” është vepër bashkëkohore me elemente autobiografike nga jeta studenteske e autorit në Moskë.

**Vëllimi 8** 464 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-59-4  
Çmimi 1250 lekë




Vëllimi i nëntë, 2008

## - NËNTORI I NJË KRYEQYTETI - TREGIME DHE NOVELA

Në këtë vëllim përfshihet romani “Nëntori i një kryeqyteti”, shkruar dhe botuar në Tiranë, në vitin 1974, si dhe një numër i madh tregimesh e novelash, shkruar midis viteve 1981 dhe 2008, në Shqipëri dhe në Francë.

Një prej tregimeve “Leximi i Hamletit”, si edhe dy novelat “Raporti i fshehtë” dhe “Bisedë për brilantet në pasditen e dhjetorit”, botohen për herë të parë.

**Vëllimi 9** 480 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-60-0  
Çmimi 1250 lekë



Vëllimi i dhjetë, 2008


**- URA ME TRI HARQE  
- KUSH E SOLLI DORUNTINËN  
- BREZNITË E HANKONATËVE**

Në këtë vëllim përfshihen romanet “Kush e solli Doruntinën” dhe “Ura me tri harqe”, si dhe rrëfimi i gjatë “Breznitë e Hankonatëve”.

Dy romanet janë bazuar mbi legjendat e njo-hura mesjetare të kthimit të nuses së martuar larg dhe të ndërtimit të një ure, e cila, për të qëndruar kërkon një fli. Të dyja veprat janë të përkthyera dhe të njobura gjerësisht në më shumë se tridhjetë gjuhë të botës.

Vepra e tretë, saga e familjes së vjetër të Gjirokastrës është një krijim i veçantë, shkruar në formën e kronikës, një traditë që në kulturën shqiptare nis me “Rrethimin e Shkodrës”, shkruar në latinisht prej Marin Barletit.

**Vëllimi 10** 400 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-61-7  
Çmimi 1250 lekë



Vëllimi i njëmbëdhjetë,  
2009


## - PRILLI I THYER - PALLATI I ËNDRRAVE

Në këtë vëllim përfshihen dy nga romanet më të njoitura e më të rëndësishme të autorit, “Prilli i thyer” dhe “Nëpunësi i pallatit të ëndrrave”.

Të shkruar njëri pas tjetrit gjatë viteve 1976 dhe 1980, janë botuar në dy përbledhje tregimesh, pa dalë kurrë si libra më vete, veçse pas rënies së komunizmit.

“Nëpunësi i pallatit të ëndrrave”, botuar më vonë me titullin “Pallati i Ëndrrave”, është kritikuar rëndë dhe më pas ndaluar si vepër me aluzione kundër regjimit. “Prilli i thyer” është ekranizuar tri herë në versione të ndryshme kinematografike, ndër të cilat, më i fundmi, i titulluar “Përtej diellit”, ka qenë i regjisorit të shqar brazilian Walter Sales.

**Vëllimi 11** 456 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-82-2  
Çmimi 1250 lekë



Vëllimi i dymbëdhjetë,  
2009


- DOSJA H.
- KRUSHQIT JANË TË NGRIRË
- QORRFERMANI
- VITI I MBRASHTË

Në këtë vëllim të dymbëdhjetë përfshihen katër vepra: "Dosja H.", "Krushqit janë të ngrirë", "Qorrfermani" dhe "Viti i mbrapshtë".

Veprat janë shkruar midis fillimit dhe gjysmës së viteve tetëdhjetë. Njëri prej tyre, "Dosja H.", u botua më 1981 në revistën "Nëntori", kurse "Krushqit janë të ngrirë" dhe "Viti i mbrapshtë" në përbledhjen "Koha e shkrimeve". Ndërsa asnjëra prej këtyre tri veprave nuk u botua si libër më vete gjatë kohës së komunizmit, "Qorrfermani" mbeti krejtësisht i pabotuar për shkak të subjektit delikat.

**Vëllimi 12** 496 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-83-9  
Çmimi 1250 lekë

---




Vëllimi i trembëdhjetë,  
2009

- HIJA
- NATA ME HËNË
- VAJZA E AGAMEMNONIT
- PASARDHËSI

Në këtë vëllim botohen katër vepra, tri prej të cilave “Hija”, “Vajza e Agamemnonit” dhe “Nata me hënë”, janë shkruar në vitet 1984-1986 në Tiranë, kurse e katërtja, “Pasardhësi”, është shkruar gati njëzet vite më pas, në Paris.

“Vajza e Agamemnonit” dhe “Pasardhësi”, ndonëse të shkruara në kohë dhe regjime të ndryshme, përbëjnë një diptik, çka ka kushtëzuar botimin e tyre bashkërisht në këtë vëllim të 13-të të veprave të autorit.

**Vëllimi 13** 512 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-84-6  
Çmimi 1250 lekë



Vëllimi i katërmëbëdhjetë,  
2009


**- PIRAMIDA  
- RRËFIM TRIKOHËSH  
- SHTATË NOVELA**

Në këtë vëllim janë botuar vepra të shkruara në Tiranë dhe në Paris, në kohën e komunizmit dhe pas rënies së tij.

Përveç romanit "Piramida", gjysma e të cilit ishte shkruar në Shqipëri dhe gjysma tjetër në Francë, dy nga pjesët e "Rrëfimit trikohësh", si dhe dy nga novelat e përfshira në "Shtatë novelat", janë të shkruara në Tiranë, në vitet tetëdhjetë. Të tjera janë shkruar dhe botuar në Paris dhe në Tiranë, midis viteve 1993-2000.

**Vëllimi 14** 480 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-91-4  
Çmimi 1250 lekë

---




Vëllimi i pesëmbëdhjetë,  
2009

- SPIRITUS
- LULET E FTOHTA TË MARSIT
- TRI KËNGË ZIE PËR KOSOVËN

Vëllimi i pesëmbëdhjetë i veprave përmban dy romane të shkruara në Francë, “Spiritus” dhe “Lulet e ftohta të marsit”, respektivisht në vitet 1995-1996 dhe 1998-2000, si edhe nove-lën “Tri këngë zie për Kosovën”, botuar më 1998.

Te “Spiritus” trajtohen ngjarje që u përkasin dy kohëve: përpara dhe pas komunizmit. Kurse “Lulet e ftohta të marsit” është një nga veprat e rralla të autorit, subjekti i të cilit bazo-het tërësisht mbi ngjarjet pas rënies së komu-nizmit në Shqipëri. Novela “Tri këngë zie për Kosovën”, u shkrua dhe u botua në prag të shpërthimit të luftës në Kosovë.

**Vëllimi 15** 480 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-90-7  
Çmimi 1250 lekë




Vëllimi i gjashtëmbëdhjetë,  
2009

- SHKABA
- ÇËSHTJE TË MARRËZISË
- AKTORI
- STINË E MËRZITSHME NË OLYMP

Në këtë vëllim, përveç dy romaneve të shkurtra “Shkaba” dhe “Çështje të marrëzisë”, është përfshirë romani tjetër “Aktori”, i njojur më parë me titullin “Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut”, si edhe drama “Stinë e mërziitshme në Olymp”. Në këtë të fundit, e vetmja pjese teatrale e Kadaresë, autori rindërton, sipas versionit të vet, trilogjinë e famshme të Eskilit, prej së cilës, pas humbjes së pjesës së parë dhe të tretë, ka mbetur vetëm pjesa e mesme “Prometheu i lidhur”.

**Vëllimi 16** 592 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-95-2  
Çmimi 1250 lekë

---




Vëllimi i shtatëmbëdhjetë,  
2009

**- AKSIDENTI  
- DARKA E GABUAR  
- E PENGUARA**

Në këtë vëllim botohen tre romanet e fundit në kohë të autorit, “Aksidenti”, “Darka e gabuar” dhe “E penguara”.

“Aksidenti”, shkruar në vitet 2003-2004 dhe publikuar për herë të parë më 2008, nga shtëpia botuese “Fayard”, në frëngjisht, botahet për herë të parë në këtë vëllim të veprave. “Darka e gabuar” është botuar në Tiranë më 2008, kurse “E penguara”, shkruar në vitet 2008-2009, është botuar për herë të parë në këtë vëllim të shtatëmbëdhjetë, dhe si libër më vete njëkohësisht.

**Vëllimi 17** 552 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-96-9  
Çmimi 1250 lekë




Vëllimi i tetëmbëdhjetë,  
2009

- **FTESË NË STUDIO**
- **ESKILI, KY HUMBËS I MADH**
- **DANTJA I PASHMANGSHËM**
- **HAMLETI, PRINCI I VËSHTIRË**
- **DON KISHOTI NË BALLKAN**

Në vëllimin e tetëmbëdhjetë, përveç sprova ve të njohura “Ftesë në studio” dhe “Eskili, ky humbës i madh”, të shkruara e të botuara, e para plotësisht dhe e dyta pjesërisht, nën rendin komunist, janë përfshirë tri sprovat e mëvonshme: “Dantja i pashmangshëm”, “Hamleti, princi i vështirë” dhe “Don Kishoti në Ballkan”, të tria të shkruara e të botuara pas rënies së komunizmit.

**Vëllimi 18** 544 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-97-6  
Çmimi 1250 lekë

---




Vëllimi i nëntëmbëdhjetë,  
2009

- LEGJENDA E LEGJENDAVE
- ARDHJA E MIGJENIT NË LETËRSINË SHQIPE
- KUSHËRIRI I ENGJËJVE
- ARTI SI MËKAT
- RA KY MORT E U PAMË
- DIALOG ME ALAIN BOSQUET

Në vëllimin e nëntëmbëdhjetë të veprës, përveç ditarit për Kosovën, të vitit 1999, të njohur nën titullin “Ra ky mort e u pamë”, dhe dialogut me shkrimtarin dhe publicistin e shqar francez Alain Bosquet, botuar disa herë në Shqipëri, përfshihen dy sprovat “Kushëriri i engjëjve” dhe “Arti si mëkat”. Kjo e fundit botohet për herë të parë në Shqipëri. Po ashtu për herë të parë batohet si libër më vete në Shqipëri “Legjenda e legjendave”, kurse “Ardhja e Migjenit në letërsinë shqipe” është publikuar për herë të parë në Paris, si parathënie e “Novelave të qytetit të Veriut” të Migjenit, përkthyer në frëngjisht.

**Vëllimi 19** 568 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-98-3  
Çmimi 1250 lekë



Vëllimi i njëzetë,  
2009

- NGA NJË DHJETOR NË TJETRIN
- PESHA E KRYQIT
- BISEDË NË "HYLLI I DRITËS"
- E VËRTETA QË DEL NGA QILARËT
- IDENTITETI EUROPIAN I SHQIPTARËVE
- SORKADHET E TREMBURA

Në këtë vëllim përmbyllës të veprës së Kadaresë, përveç dy librave dokumentarost artistikë “Nga një dhjetor në tjetrin” dhe “Pesha e kryqit”, janë përbledhur dy dialogë të tij, i pari me revistën shqiptare “Hylli i Dritës”, i dyti “E vërteta që del nga qilarët”, me shkrimtarin dhe publicistin e shquar francez Stephane Courtois. Ky dialog i dytë është botuar së pari nga shtëpia botuese franceze “Odile Jacob”, si pasthënie e botimit frëngjisht të librit “Dosja K.”, e prof. Shaban Sinanit.

“Sorkadhet e trembura”, një synops i gjerë për tjetër art, siç e ka karakterizuar autor, si edhe sprova “Identiteti europian i shqiptarëve”, janë përfshirë gjithashtu në këtë vëllim. Me përjashtim të sprovës së fundit, si edhe të intervjutës në “Hyllin e Dritës”, të gjitha veprat e tjera botohen për herë të parë në Shqipëri.

**Vëllimi 20** 592 f.; 21 cm  
ISBN 978-99943-42-99-0  
Çmimi 1250 lekë



# ShtepiaeLibrit.com

Libraria ime...

## Si mund të porosisni libra nga ShtepiaeLibrit.com ?

Përshëndetje mik i librit!

Prej 3 vitesh, **ShtepiaeLibrit.com** shërben si një **librari virtuale** ku ju mund të **informoheni** dhe të **porosisni** libra direkt nga interneti.

Ne të specializuar në **promovimin, tregtimin** dhe **dërgimin** e librave shqip.

Ne dërgojmë porosi **në çdo vend të botës**, prandaj për të porositur libra mjafton të na jepni një **adresë të saktë postimi** dhe të **konfirmoni pagesën tuaj**. Më pas librat do t'ju vijnë me postë në adresën e porositur nga ju.



Aktualisht, **mënyrat kryesore të pagesës** për porositjen e librave janë këto:

1. duke paguar me **kartat e internetit**: Visa, MasterCard, American Express ose Discover
2. duke paguar me **PayPal.com** drejt adresës tonë: [sales@shtepiaelibrit.com](mailto:sales@shtepiaelibrit.com)
3. duke i transferuar fondet në llogarinë tonë bankare në **Shqipëri** (ose në **Kosovë**)
4. duke i dërguar fondet nëpërmjet shërbimeve **Western Union, MoneyGram**, etj.

Pagesat mund të kryhen në **Euro, USD, Paund** dhe sigurisht **Lekë**. Porositë me **kartat e internetit** dhe me **PayPal** mund të kryen direkt nga faqja jonë. Për **transfertat bankare apo dërgesat** me Western Union, MoneyGram, etj, ju lutem na kontaktoni paraprakisht me email që t'ju dërgojmë informacionet që do t'ju nevojiten.



Për klientët tanë nga **Shqipëria**, ne ofrojmë mundësinë e blerjes së librave **në lekë pranë librarisë tonë në Tiranë** (afér qendrës) ose **me pagesë bankare** brenda Shqipërisë. Postimi i librave brenda Shqipërisë bëhet **FALAS** nëse porosisni më shumë se një libër. Porositë brenda Tiranës mund t'i sjellim edhe dorazi.



Për klientët tanë nga **Kosova**, përveç pagesave nëpërmjet internetit ne ofrojmë edhe mundësinë e pagesës **me transfertë bankare në Euro**. Pagesat kryhen pranë **ProCredit Bank në Kosovë**. Librat ju vijnë me postë për 1 javë nga dita e pagesës.

Mirëpresim çdo pyetje apo kërkesë tjetër që mund të keni.

--  
**Elvisi & Gjergji**

Administratorë

**E-mail:** [admin@shtepiaelibrit.com](mailto:admin@shtepiaelibrit.com)    **Tel.** +355 4 450 3262    **Mobile:** +355 68 60 52 510

**Website:** <http://www.ShtepiaeLibrit.com>

**Adresa jonë:** Libraria "Shtëpia e Librit"

Rruga e Barrikadave, Galeria Nasional (ish-Kinema 17 Nëntori), Kati I, Tirana, Albania.



# ShtepiaeLibrit.com

Libraria ime...

## How to order books through ShtepiaeLibrit.com ?

Hello there friend!

For over 3 years now, **ShtepiaeLibrit.com** has been operating as the largest **Albanian online bookstore** where you can get *informed* and *order books* directly online. We specialize in **promoting, selling** and **distributing** Albanian books.



We can deliver **anywhere in the world**, all we need is a **postal address** and **your payment** confirmation. Then your books will be shipped to the address requested by you.

Currently, the **main payment options** are as follows:

1. using a **Visa, MasterCard, American Express or Discover** card
2. using **PayPal.com** with our address: **sales@shtepiaelibrit.com**
3. by transferring funds to our bank account in **Albania (or Kosovo)**
4. by transferring funds through **Western Union, MoneyGram**, etj.

Payments can be made in **Euro, USD, Paund** and in **Albanian Lek**. **Credit card** and **PayPal** orders can be procesed directly on our website. Meanwhile, for transfers by **bank** and/or **Western Union, MoneyGram**, etj, please **contact us first by email** so that we can send you the necessary information.



For our customers in **Albania**, we offer the possibility of purchasing books in **Albanian Lek** at **our bookstore in Tirana** (near the center) or through bank transfers. **Shipping** inside Albania is **FREE** if you order more than one book. Orders inside Tirana can even be delivered directly.



For our customers in **Kosova**, besides internet payments, we also offer **bank transfers/payments in Euro** using your nearest **ProCredit Bank** branch in Kosovo. Books are then sent by mail and take less than a week to arrive.

We welcome all inquiries or questions that you might have.

**Elvis & Gjergj** Owners of ShtepiaeLibrit.com

**E-mail:** [admin@shtepiaelibrit.com](mailto:admin@shtepiaelibrit.com)    **Tel.** +355 4 450 3262    **Mobile:** +355 68 60 52 510

**Website:** <http://www.ShtepiaeLibrit.com>

**Our Address:** Libraria "Shtëpia e Librit"

Rugja e Barrikadave, Galeria Nasional (ish-Kinema 17 Nëntori), Kati I, Tirana, Albania.